



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.1739/11 prot

Datë 14.08.2024

V E N D I M
Nr. 1048/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.08.2024 me

Objekt:

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur*”, me Nr. REF-05441-05-20-2024 me objekt “*Loti 4, Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per laboratorin per aparatin Maglum 800 / ose ekuivalent i tij*” me fond limit 7 260 000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shendetesore e Specialiteteve Nr.1.

Autoriteti Kontraktor:

Qendra Shendetesore e Specialiteteve Nr.1, me adresë: Rr. “Vllazen Huta”, Tirane.

Ankimues:

Operatori Ekonomik “Genius” SHPK, me NUIS K63121801C, me adresë: Lagjja Nr.3, Rruga Jurgen Trade, Laboratori perballe ish Spitalit, Tiranë.

Subjekte të Interesuara:

Operatori ekonomik “Swissmed” SHPK, me NUIS K81323024G, me adresë Njesia Bashkiake nr.11, Rruga

Dritan Hoxha, Ndertesa 92, seksioni 4, Hyrja 28, Kodi Postar 1026, Tirane.

Baza Ligjore:

Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur,

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

- I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt - ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.
- I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.
- I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.
- I.4. Ankimesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

- II.1. Në datën 21.05.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-05441-05-20-2024 me objekt “Loti 4, Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per laboratorin per aparatn Maglum 800 / ose ekuivalent i tij”

me fond limit 7 260 000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shendetesore e Specialiteteve Nr.1.

II.2. Në datën 25.06.2024, operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, janë njoftuar elektronikisht për vlerësimin e ofertave, si më poshtë vijon:

“Swissmed” SHPK	4 990 000 lekë, kualifikuar
“Genius” SHPK	6 190 000 lekë, kualifikuar

II.3. Në datën 27.06.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit të procedurës së mësipërme të prokurimit në SPE.

II.4. Në datën 28.06.2024 pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 1739/2024 protokoll dhe me numër ankimi elektronik A/2024/4265 e operatorit ekonomik “Genius” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-05441-05-20-2024 me objekt “Loti 4, Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per laboratorin per aparatn Maglum 800 / ose ekuivalent i tij” me fond limit 7 260 000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shendetesore e Specialiteteve Nr.1.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Swissmed” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit.

Konkretisht pretendohet si vijon:

“Swissmed - Operatori ekonomik i shpallur fitues per kete procedure. Autoriteti kontraktor ka shpallur fitues operatorin ekonomik Swissmed, por ne kundërshtim me kriteret e kerkuara nga vete autoriteti kontraktor ne DST. Specifikisht me piken per kerkesat e tjera te vecanta per kualifikim per lotin nr.4, me piken 2.8.11, si me poshte.

2.8.11 Ne daten e hapjes se procedures, ne oren 09:00 ofertuesit duhet te paraqese, prane Laboratorit te Qendres Shendetesore te Specialiteteve nr.1, mostra e artikujve qe prokurohen, per Komisionin e Vleresimit te Ofertave. Mostrat te jene te shoqeruara me nje liste inventari (procesverbal) te firmosur dhe vulosur, ku te pasqyroje detaje qe pershkruajne mostrat e administruara.

Ne cdo procedure qe ka kete kerkese, per cdo operator ekonomik qe dorezon mostrat, mbahet nje procesverbal per dorezimin, ku dokumentohet procesi i paraqitjes se mostrave dhe detaje qe pershkruajne mostrat e administruara. Ky kriter vendoset nga autoriteti kontraktor atehere kur ata gjykojne te domosdoshme nevojen per te provuar qe operatori ekonomik mund te permbushi me sukses proceduren, pasi siguron aspektin teknik te ofertes dhe eshte ne gjendje te siguroje cilesine e mallit ne perputhje me te gjitha kriteret dhe specifikat teknike te kerkuara dhe te shpallura ne DST. Ne te gjitha procedurat, ku nje nga kerkesat ka qene paraqitja e mostrave dhe ne kemi qene pjesemarrës, kemi pare zhvillimin me transparence te ketij procesi dhe madje jemi

skualifikuar ne rast se nuk kemi paraqitur mostrap e kerkuara sipas specifikimeve teknike te kerkuara apo jemi paraqitur jashte afatit te zhvillimit te ketij procesi, qofte edhe me minute. Ne proceduren ne fjale ne kemi qene pjesemarres ne orarin dhe daten e vendosur nga autoriteti kontraktor dhe kemi dorezuar sipas te gjitha kushteve mostrap e kerkuara. Kemi provuar kapacitetin tone si operator ekonomik per te plotesuar me sukses objektin ne kete procedure, duke bere te mundur keshtu ofrimin e sakte dhe sipas standarteve te sherbimit nga autoriteti kontraktor.

Personi yne i autorizuar pjesemarres ka konstatuar qe ne afatin per paraqitjen e produkteve dhe ofertave saktesisht ne oren 09.00, date 11/06/2024, nuk ka pasur asnje person prezent nga operatori ekonomik Swissmed. Kerkojme procesverbalin e paraqitjes te gjithe operatoreve ekonomik brenda afatit te percaktuar saktesisht ne oren 09.00. Ne cilat baza mund te shpallet fitues nje operator ekonomik, nese nuk jane pranuar mostrap? Kemi dyshime qe ky operator mund te jene njoftuar me vone pasi jane hapur ofertat.

Sjellim ne vemendje dhe Piken 2. Kriteret e vecanta te kualifikimit me nenpiken a. Formulari Permbledhes i Vetedeklarimit, sipas shtojces 8, dhe piken 2.8.8 si me poshte, e cila eshte shkelur si dhe mbeshtetimi tek argumentimi i dhene sipas VKM nr. 285, date 19.05.2021:

2. KRITERET E VECANTA TE KUALIFIKIMIT 1. Ofertuesi duhet te paraqese: a. Formularin permbledhes te vetedeklarimit, sipas shtojces 8

2.7 KERKESA TE TJERA TE VECANTA PER KUALIFIKIM PER LOTIN NR. 4

2.8.8. Operatori ekonomik duhet te kete te punesuar te pakten 1 inxhinier te diplomuar ne profilin Inxhinieri Elektronike/ Elektrike/ Mekanike/ Informatike/ Mjekesore, gjithashtu te jete i trajnuar per pajisjet laboratorike i cili eshte objekt prokurimi (Maglium 800 Imunologji/ ekuivalent i tij) pasi do te jete pergjegjes per instalim, trajnim te stafit mjekesore dhe kalibrimin e marterialeve. Operatoret ekonomike duhet te vetedeklarojne disponimin e punonjesit te mesiperem ne formularin permbledhes te vetedeklarimit sipas shtojces 8 te DST. Shenim: ndersa operatori ekonomik i kualifikuar i pari duhet te dorezoje prane AK, perpara publikimit te njoftimit te fituesit dhe nisjes se afateve, te gjithe dokumentacionin provues si, kontraten e punes se inxhinierit, diplomen perkatese, certifikaten e trajnimit te inxhinierit nga kompania prodhuese i cili te vertetoje qe eshte i trajnuar per perdorimin e aparatit objekt prokurimi (Maglum 800/ ekuivalent i tij) si dhe listepagesen e shoqerise per muajt e fundit per vetedeklarimet mbi punonjesin (inxhinierin) e kerkuar ne DST.

Mosparaqitja ne kohen e percaktuar te operatorit ekonomik, shkel kapacitetin teknik dhe aftesine profesionale te operatorit, pasi tregon qe nuk zoteron burimet e nevojshme njerezore apo mjetet per te plotesuar dhe ndjekur kontraten me sukses, pasi nuk mund te respektoje afatet kohore dhe kerkesat e autoritetit kontraktor. Gjithashtu operatori ekonomik (Swissmed) nuk ka asnje historik ne asnje institucion publik apo privat per aparatin Maglumi 800, disa produkte sic eshte Reaction Modules, kodi: 630003. Kerkojme kontrata qe ky operator ka per kete paisje apo per kete produkte sic esht psh. Reaction Modules, kodi: 630003 me institucione publik apo privat. Produkt i domosdoshem dhe specifik per kete instrument.

Kemi dyshime qe operatori ekonomik Swissmed, nuk ka inxhinier te trajnuar per riparimin e aparatit Maglumi 800, duke qene se asnjehere nuk ka tregtuar kete aparat. Per te njejten lloj

procedure, po me kete autoritet kontraktor, ne vitin 2023 REF-71354-06-01-2023, operatori ekonomik Swissmed nuk i plotesoi kushtet profesionale dhe teknike pasi ne kete vit nuk paraqiti certifikata per trajnimin e inxhinereve per paisjen Maglumi 800, madje per asnje aparature imunologjike. Ndaj ne kerkojme qe te respektohet, te ruhet parimi i transparences dhe integriteti i procesit duke hapur dhe bere publike procesverbalet e mbajtura per kete procedure, sipas ligjit dhe udhezimeve te prokurorimit publik dhe venien ne dispozicion te dokumentacionit te kerkuar si me siper.

Ne rast se operatori ekonomik Swissmed nuk ka paraqitur mostrat e kerkuara, kerkojme skualifikimin e ketij operatori pasi nuk zoteron dhe nuk ka ne disponimim mjetet, njerezit dhe reagentet/kitet e kerkuara per te furnizuar autoritetin kontraktor duke bere qe ky i fundit te mos ofroje dot sherbim me cilesi dhe ne kohe.)

Operatori ekonomik Swissmed nuk eshte paraqitur dhe nuk ka dorezuar mostrat e kerkuara.

1- Personi yne i autorizuar ka konstatuar qe ne afatin per paraqitjen e produkteve dhe ofertave saktesisht ne oren 09.00, date 11/06/2024, nuk ka pasur asnje person prezent nga operatori ekonomik Swissmed. Kerkojme procesverbalin e paraqitjes te gjithe operatoreve ekonomik brenda afatit te percaktuar saktesisht ne oren 09.00. Kemi dyshime qe ky operator mund te jene njoftuar me vone pasi jane hapur ofertat. 2- Personi yne i autorizuar ka qene prezent gjate pranimit te mostrave, dhe operatori ekonomik Swissmed nuk ka dorezuar mostra. Kerkojme proceverbalin e dorezimit te mostrave ne afatin e percaktuar (Data 11/06/2024, ora 09.00 e specifikuar ne DST 2.8.11 nga autoriteti kontraktor). Ne cilat baza mund te shpallet fitues nje operator ekonomik, nese nuk jane pranuar mostrat? 3- Gjithashtu ky operator ekonomik (Swissmed) nuk ka asnje historik ne asnje institucion publik apo privat per aparatit Maglumi 800, disa produkte sic eshte Reaction Modules, kodi: 630003. Kerkojme kontrata qe ky operator ka per kete paisje apo per kete produkte sic eshte psh. Reaction Modules, kodi: 630003 me institucione publik apo privat. Produkt i domosdoshem dhe specifik per kete instrument. 4- Kemi dyshime qe operatori Ekonomik Swissmed, nuk ka inxhinier te trajnuar per riparimin e aparatit Maglumi 800, nuk qene se asnjehere nuk ka tregtuar kete aparat. Per te njejten procedure operatori ekonomik Swissmed ne vitin 2023 nuk i plotesoi kushtet profesionale dhe teknike pasi ne kete vit nuk paraqiti certifikata per trajnimin e inxhinereve per paisjen Maglumi 800, , madje per asnje aparature imunologjike. Ndaj ne kerkojme qe te respektohet, te ruhet parimi i transparences dhe integriteti i procesit duke hapur dhe bere publike procesverbalet e mbajtura per kete procedure, sipas ligjit dhe udhezimeve te prokurorimit publik. Dhe venien ne dispozicion te dokumentacionit provues per aftesine profesionale dhe teknike te operatorit ne fjale. Dhe ne rast se operatori ekonomik Swissmed nuk ka paraqitur mostrat e kerkuara, kerkojme skualifikimin e ketij operatori pasi nuk zoteron dhe nuk ka ne disponimim mjetet, njerezit dhe reagentet/kitet e kerkuara per te plotesuar me sukses kete procedure. Me shpalljen fitues te ketij operatori, autoriteti kontraktor krijon kushte per mosofrimin e sherbimit me cilesi dhe ne kohe.”

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të

dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 1739/2, datë 01.07.2024, me kriteret që operatori ekonomik “Genius” SHPK pretendon se nuk përmbushen nga shoqëria “Swissmed” SHPK, të parashtruara në ankesën me nr.1739 prot., datë 28.06.2024.

II.6. Në datën 03.07.2024, në Komisionin e Prokurimit Publik është protokolluar me nr. 1739/3, shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 581 prot., datë 02.07.2024, drejtuar subjektit ankimues, për dijëni Komisionit të Prokurimit Publik. Sipas kësaj shkrese rezultoi, se autoriteti kontraktor e ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik “Genius” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit si të pabazuar në ligj dhe prova.

II.7. Nëpërmjet shkrësës nr. 1739/5 prot., datë 11.07.2024, me objekt: *“Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për paraqitjen e mostrave lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Genius” SHPK”*, Komisioni i Prokurimit Publik i kërkoi autoritetit kontraktor të sjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e kësaj shkrese, informacion të hollësishëm mbi procedurën e mësipërme të prokurimit, shoqëruar me procesverbalin e KVO-së lidhur me marrjen në dorëzim të mostrave të operatorit ekonomik “Swissmed” SHPK në procedurën e mësipërme të prokurimit, sipas Udhëzimit nr.3, datë 12.04.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik, *“Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikëmostrat e paraqitura nga shoqëria “Trimed” SHPK, si dhe mostrat e dorëzuara nga ky i fundit. Gjithashtu u kërkua të silltet në KPP dokumentacioni i paraqitur nga shoqëria “Swissmed” SHPK që vërteton përmbushjen e kërkesave të autoritetit kontraktor sipas formularit të vetëdeklarimit, objekt ankimimi, shoqëruar me procesverbalin e KVO-së për marrjen në dorëzim të tyre.*

II.8. Në datën 15.07.2024, është protokolluar në Komisionin e Prokurimit Publik me nr. 1739/6 prot., shkresa e autoritetit kontraktor nr. 616 prot., datë 15.07.2024, me objekt: *“Dërgim mostra dhe dokumentacioni”*. Me anë të kësaj shkrese, autoriteti kontraktor informon se:

“[...] Me date 11.06.2024, ora 09:00 është bërë hapja e procedurës së prokurimit për të 4 Lotet, gjithashtu dhe për Lotin nr. 4 me objekt “Blerje kite, reagent dhe material konsumi për aparatën Maglum 800/ose ekuivalent i tij”, e dokumentuar sipas procesverbalit date 11.06.2024.

Nga ana e Anetareve të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave është bërë administrimi i mostrave objekt prokurimi sipas procesverbalit me nr. procesverbalin me nr. 522 prot, date 11.06.2024. Referuar DST Pika 2.8.11 ka kërkuar që Operatorët Ekonomik ofertues duhet: “Në datën e hapjes së procedurës, në orën 09:00 ofertuesit duhet të paraqesë, pranë Laboratorit të Qendres Shendetësore të Specialiteteve nr.1, mostra e artikujve që prokurohen, për Komisionin e Vlerësimit të Ofertave. Mostrat të jenë të shoqëruara me një listë inventari (procesverbal) të firmosur dhe vulosur, ku të pasqyrojë detaje që përshkruajnë mostrat e administruara”

Ky kriter është vendosur nga Autoriteti Kontraktor referuar Udhëzimit nr. 3, date 12.04.2022 “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomike”,

Paraqitja e mostrave i sherben autoritetit kontraktor per te gjykuar me mire mbi permbushjen e specifikimeve te kerkuara per objektet qe prokurohen, me qellim qe, cilesia e mallit te jete ne perputhje me kerkesat e percaktuara prej tij.

Per te dokumentuar procesin e administrimit te mostrave, autoriteti kontraktor (komisioni i vleresimit te ofertave) ka mbajtur procesverbalin me nr. 522 prot, date 11.06.2024, ku jane te specifikuar operatoret ekonomike, sipas Loteve perkatese, qe jane paraqitur sipas kerkeses ne DST, brenda ores, dates dhe vendit, te percaktuar ne DST. Ne procesverbal jane te specifikuar operatoret ekonomik te cilet jane paraqitur sipas autorizimeve perkatese dhe listen e inventarit te cilat jane verifikuar dhe fizikisht nga KVO-ja. Eshte bere verifikimi i artikujve ne lidhje me datat e skadencave dhe eshte bere vleresimi ne aspektin teknik te ofertes, me qellim qe cilesia e mallit te jete ne perputhje me kerkesat e percaktuara. Procesverbalit i jane bashkelidhur te dhe flete-iventaret e firmosura nga OE.

Persa i perket operatorit ekonomik "Swissmed" shpk, sic pershkruhet dhe ne procesverbalin e administrimit te mostrave, operatori ekonomik eshte paraqitur jashte orarit te percaktuar nga DST, pra eshte paraqitur pas ores 09:00 te dates 11.06.2024. Kjo eshte shenuar dhe ne flete-iventarin e paraqitur nga operatori ekonomik "Swissmed" shpk, ku specifikohet se eshte paraqitur me vonese dhe per pasoje nuk i jane pranuar mostrat. **Pra, mos dorezimi i mostrave ne daten, oren dhe ne vendin e parashikuar ne DST perben shkak per mospranimin e tyre nga KVO dhe konsiderohet qe Operatori Ekonomik "Swissmed" shpk nuk i ka paraqitur mostrat.** (Bashkelidhur do te gjeni procesverbalin e administrimit te mostrave dhe flete-iventaret e dorezuar nga OE, te cilat jane kopje te njesuar me origjinalin).

Me date 18.06.2024 eshte bere nga KVO-ja vleresimi dhe klasifikimi i ofertave te tenderit me objekt "Blerje kite, reagent dhe material konsumi per aparatin Maglum 800 /ose ekuivalent i tij", e dokumentuar sipas procesverbalit me nr. 544 prot. date 18.06.2024 dhe ne Lotin nr. 4 jane kualifikuar dy operatore ekonomike te cilet kane ofertuar, perkatesisht: operatori ekonomik "SWISSMED" shpk, me vlere ekonomike 4 990 000 (kater milion e nenteqind e nentedhete mije) leke pa tvsh dhe operatori ekonomik "GENIUS" shplc me vlere 6 190 000 (gjashte milion e njeqind e nentedhete mije) leke pa tvsh. Referuar vleresimit te dokumentave te tenderit te ngarkuar ne sistemin e APP-se, **rezulton se te dy operatoret i plotesojne kriteret** dhe bazuar ne kriterin e ofertes ekonomike me cmimin me te ulet operatori ekonomik "Swissmed" renditet keshtu ne vendin e pare ne klasifikim si cmimin me te ulet te ofertuar. KVO-ja ka njoftuar nepermjet sistemit operatorin ekonomik "Swissmed" shpk per paraqitjen e dokumentave provuese per vetdeklarimet e bera ne Formularin Përmbledhës të Vetdeklarimit si dhe dokumentat e paraqitura ne rrugë elektronike si dhe listen e dokumentacionit te paraqitur me numer faqesh brenda orarit zyrtar të ditës së Hene datë 24.06.2024 pranë Zyrës së Protokollit, Qendes Shendetesore te Specialiteteve nr.1 Tiranë. Kjo e dokumentuar dhe me shkresen date 19.06.2024.

Me date 24.06.2024 operatori ekonomik "Swissmed" shpk ka paraqitur prane autoritetit kontraktor, Qendra Shendetesore e Specialiteteve nr. 1, dokumentacionin provues sipas flete-iventarit bashkelidhur. Pas verifikimit te dokumentave te dorezuar eshte mbajtur dhe procesverbali nga KVO me te njejten date.

Me date 25.06.2024 Komisioni i Vleresimit te Ofertave i dergon per miratim raportin permblledhes Titullarit te Autoritetit Kontraktor, ne lidhje me klasifikimin, sipas shkreses nr. 564 prot, date 25.06.2024, ku jane propozuar operatoret ekonomike fitues sipas loteve. Perkatesisht per lotin nr. 4 eshte propozuar si fitues operatori ekonomik "Swissmed" shpk me vlere me te ulet ekonomike 4 990 000 (kater milion e nenteqind e nentedhete mije) leke pa tvsh.

Me shkresen e dates 26.06.2024 eshte ngarkuar ne sistem 'Formulari i Njoftimit te Fituesit (Paraprak)' per operatorin ekonomik "Swissmed" shpk, ku me publikimin e ketij njoftimi kane filluar dhe afatet e ankimimit sipas percktimeve ne nenin 110 te Ligjit nr. 162/2020, date 23.12.2020 "Per Prokurimin Publik".

Bashkelidhur kesaj shkrese do te gjeni mostrat fizikisht te dorezuara nga operatori ekonomik ankimues Genius shpk, procesverbalin e administrimit te mostrave nga AK si dhe kopje te njesuar me origjinalin te shkresave te permendura me lart si dhe dokumentat e dorezuara nga operatori ekonomik "Swissmed" shpk prane AK, si: formularin e vetedeklarimit te dorezuar nga Operatori Ekonomik Swissmed shpk sipas Shtojces 8, sipas se cilit verteton se ka te punesuar te pakten 1 inxhinier te diplomuar ne profilin e inxhinierise, me certifikate trajnimi nga Compania prodhuese si dhe ndodhet ne listpagesen e muajit te fundit, deklaraten e konformitetit te OE Swissmed shpk si dhe kontratat dhe fatura tatimore te realizuara me autoritete publike e private, te cilat jane kopje te njesuar me origjinalin."

Bashkëngjitur kësaj shkrese autoriteti kontraktor ka sjellë në KPP shkresën nr. 522 prot., datë 11.06.2024 me objekt: "Procesverbal administrimi të mostrave", i mbajtur nga KVO-ja, ku, ndër të tjera, thuhet se: "Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është vënë re se për Lotin nr.4 është paraqitur operatori ekonomik Genius SHPK, mostrat janë të shoqëruara me fletë inventari të firmosur e të vulosur në prezencë të vetë administratorit të shoqërisë. Nga verifikimi i mostrave rezulton se janë sipas afatit të skadencës të përcaktuara në DST.

Nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është vënë re se për Lotin 4 është paraqitur operatori ekonomik Swissmed SHPK, i cili nuk është paraqitur në orën 09:00, sic parashikohet në DST, por është paraqitur jashtë orarit të përcaktuar. Ky shënim është bërë dhe në fletën e inventarit të artikujve të paraqitur nga kompania."

Në procesverbalin e dorëzimit (lëvrimit) të mostrave, (fletën e inventarit të artikujve) të shoqërisë "Swissmed" rezulton shënimi i bërë nga znj. E.Ll si vijon: "Operatori i Swissmed është paraqitur pas orës së caktuar (pas orës 9)".

Gjithashtu është paraqitur formulari përmbledhës i vetedeklarimit të shoqërisë "Swissmed" SHPK me dokumentacionin përkatës; eksperiencat e mëparshme të shoqërisë "Swissmed" SHPK, procesverbali i KVO-së për vlerësimit dhe klasifikimit të ofertave me nr. 544 prot., datë 18.06.2024 si dhe raporti përmbledhës i procedurës së prokurimit.

II.9. Duke qënë se në përgjigjen e sjellë në KPP nga autoriteti kontraktor është sqaruar se: "Persa i perket operatorit ekonomik "Swissmed" shpk, sic pershkruhet dhe ne procesverbalin e administrimit te mostrave, operatori ekonomik eshte paraqitur jashte orarit te percaktuar nga DST, pra eshte paraqitur pas ores 09:00 te dates 11.06.2024. Kjo eshte shenuar dhe ne flete-iventarin e

paraqitur nga operatori ekonomik "Swissmed" shpk, ku specifikohet se eshte paraqitur me vonese dhe per pasoje nuk i jane pranuar mostrat. Pra, mos dorezimi i mostrave ne daten, oren dhe ne vendin e parashikuar ne DST perben shkak per mospranimin e tyre nga KVO dhe konsiderohet qe Operatori Ekonomik "Swissmed" shpk nuk i ka paraqitur mostrat. (Bashkelidhur do te gjeni procesverbalin e administrimit te mostrave dhe flete-inventaret e dorezuar nga OE, te cilat jane kopje te njesuar me origjinalin)", nËpËrmjet shkresËs nr. 1739/7 prot., datË 02.08.2024 me objekt: "KËrkesË pËr informacion", Komisioni i Prokurimit Publik i kËrkoi autoritetit kontraktor informacion tË saktË dhe tË qartË pËr gjykimin e KSHA-sË lidhur me pretendimin e ankimuesit: "[...] Operatori ekonomik "Swissmed" SHPK nuk eshte paraqitur dhe nuk ka dorezuar mostrat e kerkuara. Personi yne i autorizuar ka konstatuar qe ne afatin per paraqitjen e produkteve dhe ofertave saktesisht ne oren 09.00, date 11/06/2024, nuk ka pasur asnje person prezent nga operatori ekonomik "Swissmed" SHPK [...]"

II.10. NË datËn 08.08.2024 ËshtË protokolluar nË KPP me nr. 1739/8 prot., shkresa e autoritetit kontraktor me nr. 636 prot., datË 06.08.2024 me objekt: "DËrgim dokumentacioni", bashkËngjitur UrdhËrin nr. 36, datË 01.07.2024; shkresËn nr. 580/1prot., datË 01.07.2024 me objekt: "Vendim lidhur me ankesËn e operatorit ekonomik "Genius" SHPK pËr procedurËn e prokurimit me objekt: "Loti nr.4 "Blerje kite, reagent dhe materiale konsumi pËr laboratorit pËr aparatin Maglium 800/ose ekuivalent I tij" , Nr.Ref-05441-05-20-2024, me fond limit 7 260 000 lekË pa tvsh"; Vendimi i KSHA -sË me nr. 580 prot, datË 01.07.2024 me objekt: "Vendim lidhur me ankesËn e operatorit ekonomik "Genius" SHPK pËr procedurËn e prokurimit me objekt: "Loti nr.4 "Blerje kite, reagent dhe materiale konsumi pËr laboratorit pËr aparatin Maglium 800/ose ekuivalent I tij" , Nr.Ref-05441-05-20-2024, me fond limit 7 260 000 lekË pa tvsh, data e hapjes sË ofertave 11.06.2024"; shkresa nr. 581 prot., datË 02.07.2024 drejtuar shoqËrisË "Genius" SHPK, pËr dijeni KPP-sË, dy dËftesa postare.

II.11. Nga verifikimi i dokumentacionit tË administruar nË dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar nË informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua, se nuk ka pasur pretendime nga subjekte tË interesuara, nË pËrputhje me nenin 113 ligji Nr. 162/2020 pËr prokurimin publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit tË ankesËs, dokumentacionit bashkËngjitur saj, si dhe informacionit e dokumentacionit tË paraqitur nga ana e autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik "Genius" SHPK se: "Swissmed - Operatori ekonomik i shpallur fitues per kete procedure. Autoriteti kontraktor ka shpallur fitues operatorin ekonomik Swissmed, por ne kundërshtim me kriteret e kerkuara nga vete autoriteti kontraktor ne

DST. Specifikisht me piken per kerkusat e tjera te vecanta per kualifikim per lotin nr.4, me piken 2.8.11, si me poshte. 2.8.11 Ne daten e hapjes se procedures, ne oren 09:00 ofertuesit duhet te paraqese, prane Laboratorit te Qendres Shendetesore te Specialiteteve nr.1, mostra e artikujve qe prokurohen, per Komisionin e Vleresimit te Ofertave. Mostrat te jene te shoqeruara me nje liste inventari (procesverbal) te firmosur dhe vulosur, ku te pasqyroje detaje qe pershkruajne mostrat e administruara. Ne cdo procedure qe ka kete kerkese, per cdo operator ekonomik qe dorezon mostrat, mbahet nje procesverbal per dorezimin, ku dokumentohet procesi i paraqitjes se mostrave dhe detaje qe pershkruajne mostrat e administruara. Ky kriter vendoset nga autoriteti kontraktor atehere kur ata gjykojne te domosdoshme nevojen per te provuar qe operatori ekonomik mund te permbushi me sukses proceduren, pasi siguron aspektin teknik te ofertes dhe eshte ne gjendje te siguroje cilesine e mallit ne perputhje me te gjitha kriteret dhe specifikat teknike te kerkuara dhe te shpallura ne DST. Ne te gjitha procedurat, ku nje nga kerkusat ka qene paraqitja e mostrave dhe ne kemi qene pjesemarres, kemi pare zhvillimin me transparence te ketij procesi dhe madje jemi skualifikuar ne rast se nuk kemi paraqitur mostrat e kerkuara sipas specifikimeve teknike te kerkuara apo jemi paraqitur jashte afatit te zhvillimit te ketij procesi, qofte edhe me minute. Ne proceduren ne fjale ne kemi qene pjesemarres ne orarin dhe daten e vendosur nga autoriteti kontraktor dhe kemi dorezuar sipas te gjitha kushteve mostrat e kerkuara. Kemi provuar kapacitetin tone si operator ekonomik per te plotesuar me sukses objektin ne kete procedure, duke bere te mundur keshtu ofrimin e sakte dhe sipas standarteve te sherbimit nga autoriteti kontraktor. Personi yne i autorizuar pjesemarres ka konstatuar qe ne afatin per paraqitjen e produkteve dhe ofertave saktesisht ne oren 09.00, date 11/06/2024, nuk ka pasur asnje person prezent nga operatori ekonomik Swissmed. Kerkojme procesverbalin e paraqitjes te gjithe operatoreve ekonomik brenda afatit te percaktuar saktesisht ne oren 09.00. Ne cilat baza mund te shpallet fitues nje operator ekonomik, nese nuk jane pranuar mostrat? Kemi dyshime qe ky operator mund te jene njoftuar me vone pasi jane hapur ofertat”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e vecanta të kualifikimit”, “Kërkesa të tjera të vecanta për kualifikim për Lotin Nr.4”, pika 2.8.11 në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.8.11. Ne daten e hapjes se procedures, ne oren 09:00 ofertuesit duhet te paraqese, prane Laboratorit te Qendres Shendetesore te Specialiteteve nr.1, mostra e artikujve qe prokurohen, per Komisionin e Vleresimit te Ofertave. Mostrat te jene te shoqeruara me nje liste inventari (procesverbal) te firmosur dhe vulosur, ku te pasqyroje detaje qe pershkruajne mostrat e administruara.

III.1.2. Lidhur me pretendimin e ankimuesit, nga ana e autoritetit kontraktor, nëpërmjet shkresës nr. 616 prot., datë 15.07.2024 informon KPP-në se:

“[...] Me date 11.06.2024, ora 09:00 eshte bere hapja e procedures se prokurimit per te 4 Lotet, gjithashtu dhe per Lotin nr. 4 me objekt “Blerje kite, reagent dhe material konsumi per aparatn Maglum 800/ose ekuivalent i tij”, e dokumentuar sipas procesverbalit date 11.06.2024. Nga ana e

Anetareve te Komisionit te Vleresimit te Ofertave eshte bere administrimi i mostrave objekt prokurimi sipas procesverbalit me nr. procesverbalin me nr. 522 prot, date 11.06.2024. Referuar DST Pika 2.8.11 ka kerkuar qe Operatoret Ekonomik ofertues duhet: “Ne daten e hapjes se procedures, ne oren 09.’00 ofertuesit duhet te paraqese, prane Laboratorit te Qendres Shendetesore te Specialiteteve nr.1, mostra e artikujve qe prokurohen, per Komisionin e Vleresimit te Ofertave. Mostrat te jene te shoqeruara me nje liste inventari (procesverbal) te firmosur dhe vulosur, ku te pasqyroje detaje qe pershkruajne mostrat e administruara” Ky kriter eshte vendosur nga Autoriteti Kontraktor referuar Udhezimit nr. 3, date 12.04.2022 “Mbi procesin e administrimit te mostrave te paraqitura nga operatoret ekonomike”. **Paraqitja e mostrave i sherben autoritetit kontraktor per te gjykuar me mire mbi permbushjen e specifikimeve te kerkuara per objektet qe prokurohen, me qellim qe, cilesia e mallit te jete ne perputhje me kerkesat e percaktuara prej tij.** Per te dokumentuar procesin e administrimit te mostrave, autoriteti kontraktor (komisioni i vleresimit te ofertave) ka mbajtur procesverbalin me nr. 522 prot, date 11.06.2024, ku jane te specifikuar operatoret ekonomike, sipas Loteve perkatese, qe jane paraqitur sipas kerkeses ne DST, brenda ores, dates dhe vendit, te percaktuar ne DST. Ne procesverbal jane te specifikuar operatoret ekonomik te cilet jane paraqitur sipas autorizimeve perkatese dhe listen e inventarit te cilat jane verifikuar dhe fizikisht nga KVO-ja. Eshte bere verifikimi i artikujve ne lidhje me datat e skadencave dhe eshte bere vleresimi ne aspektin teknik te ofertes, me qellim qe cilesia e mallit te jete ne perputhje me kerkesat e percaktuara. Procesverbalit i jane bashkelidhur te dhe flete- inventaret e firmosura nga OE. Persa i perket operatorit ekonomik “Swissmed” shpk, sic pershkruhet dhe ne procesverbalin e administrimit te mostrave, operatori ekonomik eshte paraqitur jashte orarit te percaktuar nga DST, pra eshte paraqitur pas ores 09:00 te dates 11.06.2024. Kjo eshte shenuar dhe ne flete-inventarin e paraqitur nga operatori ekonomik “Swissmed” shpk, ku specifikohet se **eshte paraqitur me vonese dhe per pasoje nuk i jane pranuar mostrat. Pra, mos dorezimi i mostrave ne daten, oren dhe ne vendin e parashikuar ne DST perben shkak per mospranimin e tyre nga KVO dhe konsiderohet qe Operatori Ekonomik “Swissmed” shpk nuk i ka paraqitur mostrat.** (Bashkelidhur do te gjeni procesverbalin e administrimit te mostrave dhe flete-inventaret e dorezuar nga OE, te cilat jane kopje te njesuar me origjinalin). Bashkëngjitur procesverbalet e punës së KVO-së për marrjen në dorëzim të mostrave.”

III.1.3. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: *“1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe vepronë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”*

III.1.4.Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj.

Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor

III.1.5. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, pika 1 dhe 4, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet

asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.1.6. Në nenin 40, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose
- b) fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose
- c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.

III.1.7. Në Udhëzimin nr.3, datë 12.04.2022 të Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”, APP udhëzon si vijon:

1. Autoriteti//Enti kontraktor, mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë mostra të mallit, objekt prokurimi, kur gjykon se është e rëndësishme për vlerësimin e aspektit teknik të ofertës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë teknikisht vendosjen e kriterit për kualifikim për paraqitjen e mostrave, dhe ky argumentim duhet të pasqyrohet në

procesverbalin e argumentmit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit, i cili publikohet së bashku me dokumentet e tenderit në Sistemin e Prokurimit Publik (në vijim “SPE).

2.Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit/entit kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve të kërkuara për objektet që prokurohet, me qëllim që, cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara prej tij.

3.Për të dokumentuar procesin e administrimit të mostrave, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale, me qëllim sigurimin e transparencës dhe integritetit të këtij procesi.

Në këtë kuptim, në rastin kur autoriteti/enti kontraktor vlerëson si të nevojshëm dorëzimin e mostrave, në datën dhe në orën e përcaktuar në dokumentat e tenderit për paraqitjen e tyre nga ofertuesit, duhet të mbajë një procesverbal. Procesverbali duhet të dokumentojë procesin e paraqitjes së mostrave, si dhe duhet të pasqyrojë detaje që përshkruajnë mostrën/at e administruara.

Në këtë rast, mbajtja e procesverbaleve i shërben vetëm procesit të paraqitjes së mostrave deri në momentin e kthimit të tyre tek ofertuesit.

Procesverbali i mbajtur me ofertuesin/ofertuesit e pranishëm, i cili duhet të nënshkruhet nga të dyja palët (përfaqësuesi/it i autoritetit/entit kontraktor dhe i ofertuesit/ve), duhet t’i vihet në dispozicion ofertuesit/ve.

Në rast se, ndonjëra nga palët ka komente/pretendime, ato duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbajtur.

4.Mostrat e paraqitura nga ofertuesit duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor.

Mostrat e administruara do t’i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që, kontrata në fjalë, të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor.

Në rastin kur, procedura e prokurimit anulohet, mostrat do t’i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit. [...]”

III.1.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar,

duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.1.9. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt-shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar nga ana e operatorëve ekonomikë të plotësojnë kushtin që *ne daten e hapjes se procedures, ne oren 09:00 ofertuesi duhet te paraqese, prane Laboratorit te Qendres Shendetesore te Specialiteteve nr.1, mostrat e artikujve qe prokurohen, per Komisionin e Vleresimit te Ofertave. Mostrat te jene te shoqeruara me nje liste inventari (procesverbal), te firmosur dhe vulosur, ku te pasqyroje detaje qe pershkruajne mostrat e administruara*".

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të depozituar në KPP nga ana e autoritetit kontraktor rezulton se, nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është mbajtur procesverbal administrimi të mostrave me nr. 522 prot., datë 11.06.2024 ku konstatohet e pohuar nga KVO-ja se *operatori ekonomik "Swissmed" SHPK nuk është paraqitur në orën 09:00 (për dorëzimin e mostrave), sic parashikohet në dokumentat e tenderit por është paraqitur jashtë orarit.* Gjithashtu referuar materialeve të administruara në KPP rezulton se shoqërisë "Swissmed" SHPK nuk i janë pranuar mostrat nga AK për shkak se është paraqitur me vonese. Pra në shqyrtimin e ofertës së operatorit ekonomik "Sëismed" SHPK, nuk është bërë realizuar marrja në dorëzim e mostrave dhe më tej shqyrtimi i tyre për përmbushjen e treguesve teknike të parashikuar në Formularin e Specifikimeve Teknike, si një kriter kualifikues i konsideruar i nevojshëm nga ana e njësisë së prokurimit për kualifikimin e ofertuesve. Në procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kritereve për kualifikim, autoriteti kontraktor ka argumentua se: "**Argumentimi:** *Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar Udhezimin nr. 03, date 12.04.2022 "Mbi procesin e administrimit te mostrave te paraqitura nga Operoret Ekonomik", sipas se ciles Autoriteti Kontraktor mund tu kerkoje operatoreve ekonomik te dorezoje mostra te mallit, objekt prokurimi. Paraqitja e mostrave eshte e rendesishme per vleresimin e aspektit teknik te ofertes, me qellim qe cilesia e mallit te jete ne perputhje me kerkesat e percaktuara*". Pra vetë AK e ka parashikuar kriterin për paraqitjen e mostrave si të rendesishëm për vlerësimin e aspektit teknik të ofertes, me qëllim që cilesia e mallit të jete në përputhje me kerkesat e përcaktuara, ndërkohë që nuk është bërë e mundur të gjykohej për këtë kapacitet të shoqërisë "Swissmed" SHPK, përderisa mostrat janë paraqitur jashtë afateve të paracaktuara në dokumentat e tenderit dhe ia kthyer mbrapsh shoqërisë objekt ankimimi.

Komisioni gjykon se autoriteti kontraktor mund t'u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit, të tilla si mostra të mallit kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike sikundër është kërkuar në këtë procedurë prokurimi. Mostrat - referuar edhe legjislacionit në fuqi-, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor. Nuk mund të lejohet kualifikimi i një operatori ekonomik në rast se ai ka mungesë fizike dokumentacioni apo mostre dhe nuk plotëson kriteret e përcaktuara nga vetë autoriteti kontraktor. Referuar legjislacionit në fuqi, mostra i shërben autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik disponon kapacitete për të siguruar produktin sipas specifikimeve të kërkuara, sidomos në rastin konkret që objekt i prokurimit janë artikuj me një specifikë të veçantë dhe mosrespektimi i specifikimeve teknike të kërkuara do të ndikonte në funksionalitetin e tyre.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik "Swissmed" SHPK nuk e ka plotësuar kriterin e vendosur nga autoriteti kontraktor, në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, në lidhje me paraqitjen e mostrave. KPP gjykon, se mungesa fizike e dokumentacionit të kërkuar shprehimisht në kriterin e kualifikimit, përbën shkak për skualifikim në kuptim të nenit 82 të Vendimit Nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se Komisioni i Vlerësimit të Ofertave verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kërkesat për kualifikim, të përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe janë të përgjegjshme/vlefshme.

Pretendimet e ankimuesit qëndrojnë.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të operatorit ekonomik ankimues "Genius" SHPK, për skualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik "Swissmed" SHPK në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimet e mësipërme qëndrojnë, pasi operatori ekonomik "Swissmed" SHPK nuk përmbush kriteret e kualifikimit, dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsytimit të KPP do të jetë e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshon gjendjen juridike të këtij operatori ekonomik, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim, në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, "Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik", Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 "Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik", nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e

Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Genius” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-05441-05-20-2024 me objekt “Loti 4, Blerje Kite, Reagente dhe materiale konsumi per laboratorin per aparatn Maglum 800 / ose ekuivalent i tij” me fond limit 7 260 000 lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 11.06.2024 nga autoriteti kontraktor, Qendra Shendetesore e Specialiteteve Nr.1.
2. Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin për kualifikimin e operatorit ekonomik “Swissmed” SHPK, duke e skualifikuar atë.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet për kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatorit ekonomik “Genius” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

